

BALLKANOLOGJIA SI DETYRË SHKENCORE

Ballkani paraqet një ndër hapësirat më të vjetra kulturore evropiane.

Ky supozim do të kishte sjellë me vete jashtë rajonit në fjalë para dy dekadash e gjysmë më shumë kundërshtime se sot.

Brenda rajonit reagimet janë edhe sot shumë të ndryshme. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, e cila me zgjedhjen e saj më nderon mua me anëtarësimin a saj, e ka qendrën në zemrën e rajonit kulturor dhe historik të ashtuquajtur Ballkan.

Dhe këtu, afër Ulpianës, në një rajon, i cili Perandorisë Romake i ofroi sundues të rëndësishëm dhe i cili në antikitetin e vonshëm paraqiste njërën ndër shtyllat kryesore të ushtrisë romake, trashëgimia kulturore jo vetëm shihet, por është edhe pjesë e vetëkuptimit kulturor.

Kush e sheh Ballkanin si hapësirë historike, dhe kështu operon shumica e hulumtuesve të shkencave shoqërore brenda dhe jashtë rajonit, e thekson zakonisht trashëgiminë e perandorive të mëdha, të Bizantit dhe të Perandorisë Osmane.

Theksimi i kësaj trashëgimie është njëkohësisht edhe ai konsens që rrjedh nga debatet e gjata rreth konstruktimit të hapësirave në 30 vitet e fundit. Por ky konsens bazohet në një këndvështrim të shkurtuar, sepse lë anash antikitetin.

Roma e Parë, dhe jo vetëm e Dytë, ka pasur ndikim vendimtar mbi Ballkanin: dëshmia më e mirë janë ato kombe moderne, të cilat rrjedhin nga shoqëri të vjetra ballkanike, p.sh. rumunët dhe vllehtë e romanizuar si dhe shqiptarët e prekur pjesërisht nga ndikimi kulturor romak.

Që Roma e Parë dhe etnitë e akulturuar nga ajo nuk është më pikërendesë e hulumtimeve jashtë-rajonale, kjo ka të bëjë me një përfundim të gabuar: mendimi se historia e Ballkanit filloka me paraqitjen e elementit sllav dhe se ardhja e sllavëve paska krijuar një tabula rasa.

Pse e paraqes këtë vështrim në fillim të shtjellimit mbi ballkanologjinë?

E bëj këtë me bindjen se ballkanologjia është ajo shkencë ndërdisiplinore, e cila në kundërshtim me shkencat shoqërore me orientim kombëtar dhe të interesuara vetëm për të tashmen, është e vetmja në gjendje ta përcaktojë vërtetë rëndësinë e këtij rajoni në një kontekst evropian dhe mesdhetar.

Dhe sepse kjo është e vetmja shkencë, e cila edhe e ka kuptuar këtë.

Këtë tezë dua ta shtjelloj më hollësisht si vijon.

Në një hap të parë përpiqem të sqaroj se themeluesit jashtërajonalë të ballkanologjisë e kanë parë qartë karakterin e plotësuar me elemente josllave, pra shqiptare, vllahe, greke, rumune dhe më vonë edhe turke dhe rome dhe e kanë realizuar këtë në praktikën e tyre shkencore.

Në një hap të dytë do të paraqes mendimin mbi Ballkanin, se si është kuptuar ai si hapësirë unike historike dhe kulturore brenda rajonit në shkencë - këtu do të bëhet fjalë për ndërlidhshmërinë mes ballkanologjisë, federalizmit ballkanik dhe ballkanizmit si strategji të thurura ekspansioniste kombëtare.

Në këtë kontekst hyn edhe historia e ballkanologjisë në kohën e Luftës së Ftohtë si instrument shkencor-politik për kapërcimin e linjave konfliktuale ndërrajonale.

Në një hap të tretë dhe të fundit përpiqem të vë në pah mundësi të hulumtimeve të sotme mbi Ballkanin.

Interesi për gjuhët dhe kulturat e hapësirës së Ballkanit është ngjeshur rreth fundit të shekullit 18 sidomos në hapësirën gjermanishtfolëse.

Për t'u theksuar në këtë kontekst është se edhe këta përfaqësues të hershëm të një ballkanologjie avant la lettre shtruan pyetje që diskutohen edhe sot mbi kulturën e rajonit dhe u përpoqën të japin përgjigjet e para: p.sh. raportet reciproke midis gjuhëve të vjetra të Ballkanit, pra raportet midis shqipes, rumanishtes dhe greqishtes, si dhe pozita e tyre ndaj gjuhëve sllave dhe ndaj turqishtes.

Johann Thunmann trajtoi sidomos gjuhët e vjetra të Ballkanit, pra ato jo sllave. Përfshirja e gjithë kompleksit gjuhësor dhe kulturor pasoi pastaj në Vjenë nëpërmjet themeluesve të mirëfilltë të një filologjie sistematike të Ballkanit, si Bartholomäus Kopitar dhe Franz Ritter von Miklosich. Interesi i monarkisë austriake për këtë hapësirë sqarohet lehtë.

Censura në periudhën pararevolucionare në vitet 1815-1848 kishte për të kontrolluar një numër të madh gjuhësh të monarkisë.

Kontroll pa kuptim, kontroll pa normim është vështirë e mundur të ketë. Dhe kështu erdhën paralelisht censura, normimi i gjuhëve dhe kontrolli i tyre. Por kufinj të gjuhësorë nuk përputheshin me kufijtë politikë.

Në kohën e Kopitarit dhe të Miklosichit hapësira e Ballkanit ishte kryesisht njësi politike nën Perandorinë Osmane; shteti i vogël grek i përzier etnikisht në periferinë jugore dhe shteti i pavarur dhe po ashtu i vogël serb nuk luanin pothuaj fare ndonjë rol.

Nga Vjena këta dijetarë shihnin një hapësirë politike unike, gjë që ua lehtësonte përfshirjen e një hapësire më të madhe kulturore.

Kjo pasojë e raporteve politike ndaj drejtimit të strategjive hulumtuese nuk duhet nënvlerësuar: sot do të shihnin të njëjtit hulumtues një numër të madh shtetesh të pavarura, çfarë të shtyn të fokusosh më shumë struktura nacionale se struktura rajonesh më të mëdha.

Jo kot u përpilua në Vjenë një koncept i një hapësire kulturore të Evropës Juglindore, ai koncept që përdoret deri më sot paralelisht me termin Ballkan.

Kopitari dhe Miklosichi e kuptonin qartë këtë hapësirë si një rajon të ndikuar jo tërësisht nga sllavishtja: pikërisht larmia gjuhësore dhe kulturore qëndronte në qendër të vëmendjes së këtyre dijetarëve. Kopitari ndikoi edhe në një fushë tjetër themelore të hulumtimeve ballkanike të Vjenës:

më 1829 ai punoi i pari në të ashtuquajturin „Balkansprachbund“, pra lidhja gjuhësore ballkanike: shqipja, bullgarishtja dhe rumanishtja paskan një „formë gjuhësore“ të përbashkët me tri „materie gjuhësore“¹

Prandaj linguistika moderne ballkanike e sheh Kopitarin si njo tip paraardhësi, i cili themeloi studimet krahasuese të gjuhëve sllave, të gjuhëve të vjetra ballkanike si shqipja (te Kopitari akoma jo greqishtja e vjetër), të gjuhëve romane (rumanishtja, vllahishtja, judezmo/ spanjishten hebraike e sefardëve), pastaj turqishtja dhe gjuha rome.

Miklosichi më 1849 u bë profesor i një katedre sllavistike në Vjenë, por puna e tij shkencore duhet të shihet si gjithë-ballkanase, sepse ai ndiqte parimet e Kopitarit.

Në vitet ,30, mund të dallojmë pra shumë qartë mes një ballkanologjie, e cila përfshinte Ballkanin si hapësirë kulturore, e pranishme qysh prej antikitetit dhe e karakterizuar nga shumëgjuhësia dhe kontaktet e ngushta kulturore dhe një drejtimi

¹ Victor Friedman, Contact and Consciousness in the Balkan Sprachbund, në: Friedman, *Studies*, 457 - 477, këtu 472.

shkencor juglindor, i cili i shërbente sidomos legjitimitetit shkencor të një strategjie ekspansioniste të politikës së jashtme.

Ky diferencim hapësirash në hulumtimet për Ballkanin dhe për Evropën Juglindore në hulumtimet e Evropës Qendrore nuk mund të mbivlerësohet në rëndësinë e tij, sepse ai vazhdon edhe pas vitit 1945. Hulumtimet juglindore nuk kanë qenë vetëm fillimisht të politizuara.

Programi ishte qartë historik shkencor dhe përbërja e stafit punonjës garantonte përfshirjen e trashëgimisë imperiale të bizantinëve dhe osmanëve.

Natyrisht kjo revistë u shua me pensionimin e shumë protagonistëve. Debati i filluar sidomos nga Maria Todorova në lidhje me keqpërdorimin e termit Ballkan shtyu shumë studiues të kalojnë në termin Evropë Juglindore.

Por, siç do të tregohet në një hap të dytë, termi Ballkan është politizuar po ashtu ashpër brenda vetë Ballkanit nga intelektualë dhe studiues ashtu si edhe jashtë rajonit.

pandan shkencor ndaj kësaj ideje të Ballkanit të institucionalizuar - por duhet kujtuar, se në kohën mes dy luftërave botërore ideja e një Ballkani që duhej të bashkohej politikisht, përjetoj fazën e lulëzimit.

Internacionalja Komuniste pas vitit 1918 e kishte ripërtërirë idenë e një Federate Ballkanike, e cila në fund të fundit rridhte nga koncepti kushtetutor i Rigas Ferraos Velestinlis.

Në anën tjetër fuqitë e mëdha antirevizioniste në rajon ndiqnin strategjinë, që ta popullarizonin idenë e Ballkanit, p.sh. nëpërmjet Olimpiadës Ballkanike.

Me Ami Bouë, Felix Kanitz dhe Johann Georg von Hahn u zgjeruan nga dijetarë që nuk kontribuonin në universitete trajtimet për Ballkanin me fusha si gjeografia dhe antropologjia.

Pak a shumë vonë erdhën edhe hulumtimet historike, për të cilat si paradigmatic shihet Konstantin Jirecek, i cili fillimisht në qendër të vëmendjes kishte historitë bullgare dhe serbe, por në një fazë të vonë ai u mor intensivisht edhe me historinë shqiptare.

Por kur ky u bë profesor në Vjenë, aty kishte pasuar një ndryshim paradigmesh: pasardhësi i Miklosichit Vatroslav Jagic, një pansllavist i përbetuar, la anash perspektivën ballkanike në favor të asaj sllavistike. Kjo do të thotë se katedra e rëndësishme e reduktoi qenësisht dimensionin josllav të Ballkanit.

Kjo pastaj u kompensua afërsisht me arkeologun Carl Patsch, i cili themeloi muzeun shtetëror (Landesmuseum/ Zemaljski muzej) në Sarajevë dhe pas dëbimit të tij nga mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve më 1918 edhe Institutin e Ballkanit në Vjenë, në të cilin studiuuan shumë dijetarë shqiptarë, (Buda dhe Cabej janë më të njohurit). Patsch e fokusoi sërish qartë rëndësinë e antikitetit.

Kur më 1934 qeveria austriake mbylli Institutin e Ballkanit për shkaqe financiare, ballkanologjia në Vjenë u mbajt me figura gjuhëtarësh si Nikolaj Trubeckoj dhe Norbert Jokl.

Trubeckoj si përfaqësues i rëndësishëm i teorisë për „Balkansprachbund" dhe Jokl si linguist aktiv klasik për Ballkanin me pikërendesë albanologjike, por të dy u bënë viktima të orientimit ideologjik të nacionalsocializmit, i cili propagonte „hulumtime juglindore" (Sudost-Forschung).

Ato i afroreshin rajonit në mënyrë decisive nga veriperëndimi drejt juglindjes dhe fillimisht u interesonte elementi gjerman dhe me këtë veriu i rajonit, i cili u quajt Evropa Juglindore, pra kryesisht Hungaria.

Instituti Juglindor në Mynih i themeluar më 1930 i zgjeroi kompetencat e tij dalëngadalë në drejtim të juglindjes dhe u mor pas vitit 1945 me gjithë rajonin nga Morea deri te Karpatet.

Por ngaqë Hungaria u përfshi tërësisht në këtë konceptim, bëhej fjalë më shumë për një kornizë heuristike se për një hapësirë kulturore të mirëfilltë me kritere të qarta klasifikuese.

Paralelisht me këtë termi i Ballkanit vazhdonte të përdorej: në njërin anë në ballkanologji, e cila në vendet gjermanishtfolëse (jo si në Francë) ishte zhvilluar në një shkencë kulturore, që përfshinte sidomos letërsinë, antropologjinë, sociolinguistikën dhe gjuhësinë klasike, por pak ose pothuaj fare historinë.

Ky program kulturor shkencor realizohet te revista „Zeitschrift fur Balkanologie“, e cila merret me elemente lidhëse në kulturën materiale (si veshja, mënyra e të ushqyerit, muzika) dhe në letërsi.

Në Munih, qendra e Institutit Juglindor me orientim historik dhe politik shkencor, në vitet ,70 të shekullit të kaluar lindi një iniciativë e re, e cila solli në fokusin e saj Ballkanin dhe jo Evropën Juglindore: një iniciativë dijetarësh të universitetit me përkufizim nga Instituti Juglindor jouniversitar.

Revista „Munchner Zeitschrift fur Balkankunde“ mbahej nga bizantinistë, osmanistë, sllavistë dhe historianë për Ballkanin, të cilët, si Peter Bartl, treguan një interes të theksuar për historinë shqiptare.

Ballkanologjia zbatohet sot kryesisht në Ballkan.

Por zhvillimi i institucioneve është nxitur nga dijetarë, të cilët kultivonin kontakte të ngushta me botën shkencore gjermanishtfolëse dhe ishin të formuar shpesh edhe në Vjenë.

Paradigma e Vjenës kishte ndikim të fortë sidomos në Serbi dhe Bullgari. Zhvillimi i një fushe për hulumtime të Ballkanit në Serbi, e cila paraqiste fillimet e ballkanologjisë (roli i pionierit?), kishte të bëjë në mënyrë të theksuar me legjitimimin shkencor të kërkesave territoriale të shtetit serb ndaj territoreve të Perandorisë Osmane dhe të Austro-Hungarisë.

Për studiuesin e formuar në Vjenë, me kompetencë të lartë dhe tepër të politizuar qëndron paradigmatisht emri Jovan Cvijic, te historianët mund të përmendej Aleksa Ivic ose Jovan Radonic.

Hulumtime të Ballkanit quheshin trajtimet e një hapësire vetëm pas vitit 1918, në të cilën Serbia kërkonte hegjemoni politike.

Dhe këto hulumtime të realizuara në Institutin Juglindor të Beogradit kishin një detyrë të qartë politike: ato duhej të legjitimonin shkencërisht Paktin Ballkanik të vitit 1934 dhe të krijonin një identitet ballkanik, i cili duhej të distancohej nga Gjermania nacionalsocialiste, Italia fashiste dhe Unioni Sovjetik komunist.

Në këtë Ballkan Jugosllavisë domethënë edhe Serbisë duhej t'i jepej roli kryesor.

Në revistën e Institutit në fjalë botonin korifej të hulumtimeve të Ballkanit nga gjithë Evropa, ndërsa në publikimet në gjuhën serbe propagohej „njeriu ballkanik“.

Brenda rajonit të Ballkanit as Shqipëria e as Bullgaria apo Greqia nuk ofruan ndonjë

Ndërsa në këtë kontekst u fuqizua balancimi mes Greqisë dhe Turqisë, Shqipëria dhe Bullgaria nuk i gjetën të pasqyruara interesat e tyre vitale në konceptin e Ballkanit të përfaqësuar nga Jugosllavia.

I lënë jashtë konceptit ballkanik jugosllav ishte shtetit i dytë i madh fitimtar Rumania.

Rumania, e cila vetëkuptohej si bastion kundër bolshevizmit dhe si shteti më i madh i lirë ortodoks, e shihte veten si fuqi hegjemonale në një rajon, të cilin elita rumune e definonte herë si Evropë Juglindore e herë si Ballkan.

Një Evropë Juglindore të madhe mbi një trashëgimi të vjetër ballkanike, romake, bizantine dhe osmane përfaqësonte Nicolae Lorga, duke insistuar për antikitetin, Bizantin dhe për një Perandori Osmane me ndikim bizantin, ai u caktoi rumunëve, si grupi më i madh etnik, një rol udhëheqës historik, ndërsa serbët në konceptimin e tij përbënin më shumë një element periferik: qendra e Evropës së tij Juglindore shtrihej në Egje, në Bosfor, në Detin e Zi. Ishte e vjetër ballkanike, romane dhe bizantine- greke.

Në vitet e hershme ,40 të shekullit të kaluar - pas marginalizimit politik dhe vrasjes së lorgas - në Bukuresht nën diktaturën e Mareshalit Ion Antonescu u themelua një Institut Ballkani, i cili iu besua Victor Papacosteas. Papacostea ishte me prejardhje vllahe dhe ngriti një program, i cili duket jashtëzakonisht modern.²

Një studiues me prejardhje vllahe ndoshta ishte në gjendje ta perceptonte Ballkanin si rajon me ndërlidhje të shumanshme, me theksim të elementit të vjetër ballkanik, - ai fliste për një simbiozë kulturore të trako-ilirëve dhe grekëve, të migracioneve dhe të proceseve të forta shkrirëse, në të cilat në lindje të Ballkanit moti para Osmanëve ishin të përfshirë popujt turkë si protobullgarët, kumanët dhe peçenegenët;

në mënyrë eksplicite ai bazohej te Thunmanni, Kopitari, Miklosichi, Gustav Mayeri dhe te Gustav VVeigand, i cili në Rumani ishte i njohur për hulumtimet vllahe, pastaj te historianët lorga dhe Jirecek.

Etnitë e Ballkanit ai nuk i shihte si etnitete të ndara qysh nga kohë të lashta, por më shumë e theksonte kontaktin kulturor, lidhjen gjuhësore (pra, Sprachbund), por edhe karakterin e fortë të perandorive romake, bizantine dhe osmane, elitat e të cilave rekrutoheshin në pjesën dërmuese nga Gadishulli Ballkanik.

Me rëndësi është që mendimi i tij për Ballkanin ishte më pak politik dhe më pak i kufizuar nga jashtë se së fundit koncepti serb-hegjemonal i Institutit të Ballkanit në Beograd: Ballkani i Papacosteas ishte një rajon i hapur nga të gjitha anët në lëvizje të fortë - vllahishtja në të menduarit e tij nuk duhet të mbivlerësohet.

Bien në sy tërësia dhe largpamësia, theksimi i formave kulturore kalimtare, i lëvizjes dhe i komunikimit.

Prandaj koncepti i tij përbën një programatikë shkencore të pjekur të një studiuesi jokomunist.

Pas vitit 1945 të gjitha vendet e Ballkanit u morën me ballkanologji, më pak Shqipëria, e cila fillimisht duhej të krijonte një shkencë kombëtare të veten: në Beograd dhe në Sarajevë për të parën herë, në Solje, në Selanik (jo në Athinë) dhe në Bukuresht, por jo në Turqi, e cila u tërhoq në histori kombëtare.

Pikërendesat dhe interesat u përkufizuan sërish: perdja e hekurt shtrihej në mes të Ballkanit dhe ndarja ishte shumë më e rreptë se mes fuqive revizioniste dhe antirevizioniste para Luftës së Dytë Botërore. Por ngaqë rajoni u nda politikisht:

Greqia si pjesë e NATOs, Jugosllavia pa bllok, Bullgaria me luajalitet për Moskën, Rumania me një kurs politik të jashtëm, i cili sa vinte bëhej më vetjak dhe Shqipëria e

² Victor Papacostea, La Peninsule balkanique et le problème des études comparées. *Balkanica* 6 (1943) III - XXI.

vetizoluar, dalëngadalë Ballkani përbënte një zonë tepër komplekse të Luftës së Ftohtë: marrëdhëniet shkencore paraqisnin një mundësi për të komunikuar jashtë kufinjve të bllokut.

Këtu në kuadër të UNESCOs termi Evropë Juglindore u përdor zyrtarisht, edhe pse termi Ballkan paralelisht nuk u la anash. Organizata Association internationale des études sud-est européennes bënte pjesë në politikën e jashtme kulturore të shteteve pjesëmarrëse dhe kishte gjithmonë karakter zyrtar.

Dhe ngaqë ishin të përfshirë edhe hulumtues nga perëndimi, UNESCO kontaktit mes blloqeve i ofroi një platformë të rëndësishme.

Jo rastësisht qendra ishte në Bukuresht, në një vend të Paktit të Varshavës, por që merrej për një vend më pak luajal ndaj Moskës. Ndërsa Beogradi luajti një rol të rëndësishëm në e mosinkuadrimit (Blockfreie Bewegung?), Bukureshti shpresonte një rol të madh në pozitën udhëheqëse simbolike në hapësirën e konceptuar nga lorga, por edhe të mbushur me program shkencor nga Papacostea.

Sa e rëndësishme ishte kjo platformë para vitit 1989, aq shpejt u tregua si sterilitet shkencor pas 1989-s - ajo ishte e paaftë të reagojë ndaj ndryshimeve dhe shkatërrimit të Jugosllavisë, të nxitura nga nacionalizmi serb, por edhe ndaj përmbysjes së qeverive komuniste në gjithë rajonin. Elita shkencore ishte tepër e lidhur me sistemet komuniste.

Kjo krizë legjitimiteti ra me krizën e rëndë ekonomike, e cila zgjat deri më sot.

Shpërthimi nationalist në Jugosllavinë e hershme nuk lejoi pothuaj fare më disiplina dhe perspektiva tjera në shkencë përveç atyre kombëtare. Dhe jashtë Ballkanit sulmi i Maria Todorovas sikur e nxori termin nga përdorimi.

Prandaj rreth vitit 2000 ballkanologjia brenda dhe jashtë rajonit u gjend në një krizë të thellë.

Por kjo ka ndryshuar shumë, dhe me këtë kaloj në pjesën e tretë të shtjellimeve të mia. Këtë pjesë të tretë dua ta ndaj në dy hapa:

fillimisht tregoj në bazë të veprave të dy anëtarëve të jashtëm të kësaj akademie, se si mund të merresh me ballkanologji si disiplinë evropiane. Pastaj përpiqem të përfshij dhe të paraqes tendenca dhe botime shkencore, të cilat përbëjnë potenciale për zhvillim të mëtejshëm të shkencës ballkanologjike.

Ndër anëtarët e kësaj akademie, nëpërmjet veprës së tyre në fushën e ballkanologjisë, dy kanë treguar rrugë të rëndësishme, Victor Friedman në gjuhësi dhe Noel Malcolm në histori - si historian më pak të vlerësoj veprën e Friedman-it, por lejohen disa vërejtje.

Hulumtimet e tij në lidhje me „Sprachbunden" dhe me kontaktet e shqipes, sllavishtes jugore dhe turqishtes qëndrojnë për një paradigmë të kuptimit të Ballkanit si një hapësirë kulturore, e cila karakterizohet nga kontakte kulturore me qindra, me mijëra vjet deri te marrëdhëniet simbiotike - një shtresim kulturor, të cilin Friedman e bën të kapshëm me metoda gjuhësore.

Për këtë ai ndërmerr hulumtime gjuhësore në terren, merret intensivisht me historinë e shkencës, të cilën unë fillimisht e skicova. Tri shtresat e historisë gjuhësore - ballkanase e vjetër/ sllave/ turke dhe rome, të cilat ishin të lidhura me rrjedhat e perandorive të mëdha, dalin në dritë qartë. Në rastin e Noel Malcolm-it unë bazohem në librin e tij të sapobotuar „Agents of Empire", në të cilin Malcolm nuk ndërmerr

asgjë të vogël, përveç se të shkruajë një histori evropiane me shembullin e familjes shqiptare-katolike Bruni/ Bruti nga Ulqini.

Historia shqiptare është histori Ballkani, është histori evropiane - kjo mund të merrej si moto në lidhje me këtë libër në gjysmën e dytë të shekullit 16:

Anëtarë të kësaj familjeje luftonin në poste të larta në betejën e Lepantit (1571), shërbenin në Urdhrin e Johanitëve, fusnin me intriga në Stamboll princër të Moldavisë dhe fitonin atje pasuri; ata ishin po ashtu edhe farefis me rrethe shqiptare-myslimane në Stamboll dhe merreshin me politikë të madhe.

Një histori familjeje mes Maltës dhe Avignonit, Stambollit dhe lashit, një histori spanjollësh, venecianësh dhe osmanësh, pas të cilëve gjendeshin shqiptarë katolikë dhe myslimanë - ku një prej tyre hartoi në italisht përshkrimin më të vjetër të Shqipërisë.

Shqiptarët shfaqen si etni evropiane në perandori të ndryshme dhe mes tyre, gjithmonë besnikë ndaj zotërinjve të tyre, por pa harruar prejardhjen e tyre.

Nga farefisnia e largët e kësaj familjeje rridhte Veziri i Madh Sinan Pasha, i cili njihet edhe këtu për vakëfin e tij sidomos në Kaçanik.

Sinani në Stamboll udhëhiqte grupin që mund të quhet lobi shqiptar-osman; rivalët e tij ishin myslimanët serbo-boshnjakë rreth Sokolovicit. Se sa vlente gjuha u pa qartë kur Sinani u ndie i fyer nga Dubrovniku, sepse vezirëve të mëdhenj dhe personaliteteve të tjera stokavishtfolëse u bënë më shumë peshqeshe, ndërsa Sinani shqiptar kishte përshtypjen se nuk u nderua sa duhet - gjë që Dubrovnikasit e korrigjuan shpejt. Malcolm përdor burime dhe bibliografi në të gjitha gjuhët evropiane, dmth. edhe në të gjitha gjuhët e Ballkanit dhe historia e tij mbi Brunit apo Brutit tregon, se as historia shqiptare as e Ballkanit nuk mund të shkruhen si histori e mbyllur.

Kush do të shkruajë një histori të tillë, duhet t'i përballojë burimet në gjuhët italisht, spanjisht, gjermanisht, frëngjisht, anglisht, osmanisht, sllavishte kishtare, greqisht dhe rumanisht dhe paleografinë përkatëse dhe të punojë në Venedik, Romë, Simancas, Dubrovnik, Vjenë, Innsbruck, Stamboll, Paris dhe Londër.

Ai duhet të dijë të lexojë shqip, bullgarisht, serbisht, rusisht - shkurt ai duhet të jetë një intelektual evropian i vërtetë. Dhe këtu qëndrojnë fascinimi dhe njëkohësisht edhe sfida e ballkanologjisë: merr një në dukje fenomen të vogël, lokal dhe rajonal, dhe menjëherë gjendesh në ndërlidhje të mëdha, evropiane dhe mesdhetare, pavarësisht se a e bën si historian, apo si gjuhëtar apo si arkeolog.

Çfarë na tregojnë këta shembuj?

Ata na mësojnë se duan menduar bashkë gjërat të cilave u përket të jenë bashkë; se shkencë moderne nuk ndan aty, ku ekziston diçka e rritur organike; se ne nuk e përcaktojmë shkencën sipas kompetencave tona, por e kundërta i përvetësojmë ato kompetenca që na duhen për një objekt kompleks si Ballkani si hapësirë kulturore.

Një figurë tjetër shqiptare e sqaron këtë kompleksitet për kohën e re, një figure që në Kosovë me të drejtë shihet si simbol i rëndësishëm:

Hasan Prishtina. Për ta kuptuar atë si figurë historike, duhet si për Brutin/ Brunin nga Ulqini, një këndvështrim mbarëevropian, studime nga Ankaraja deri në Londër, nga Roma deri në Moskë, zotërim i të gjitha gjuhëve evropiane dhe njohur nga të gjitha arkivat.

Hasan Prishtina lëvizte si Brutit/ Brunit në shumë botëra, por të cilat përbënin një jetë - kurse historiografia deri më tash ka dështuar në kompleksitetin e biografisë së kësaj figure.

Brutit/ Brunit në shekullin 16 dhe Hasan Prishtina në të tretën e parë të shekullit 20 tregojnë paradigmatisht se si një histori kombëtare - në këtë rast shqiptare - kushtëzon historinë ballkanike dhe evropiane-mesdhetare.

Në vitet e fundit shkenca ka filluar në kontekste të tjera gurëve të shumtë mozaikë t'u japë konture më të mëdha:

kjo vlen sidomos për ortodoksinë në Perandorinë Osmane, të cilën studiues si Raymond Detrez, Paschalis Kitromelides, Ioannis Zelepos dhe Konrad Petrovsky nuk e lexojnë më në kategori nacionale, por në shoqëri mbarëballkanase, në kuptim të një shoqërie romeike (romaikos) ortodokse ballkanike.

Studiues francezë kanë përpiluar një bibliografi mbi islamizimin në Ballkan në Perandorinë Osmane - por ne akoma dimë shumë pak në lidhje me pozitën e Ballkanit në Perandorinë Osmane: konkurrenca e përmendur më parë e myslimanëve shqiptarë dhe sllavë në oborrin sulltanor p.sh. duhet të studiohet shpejt më thellësisht, ashtu si marrëdhëniet e trajtuara shqiptare-myslimane - boshnjake në një kontekst tjetër të këngëve kreshnike.

Aktualisht historianë të historisë së vjetër shkruajnë nën drejtimin e kolegut tim nga Vjena Fritz Mitthof për të parën herë qysh nga Theodor Mommsen një histori të Ballkanit romak.

Në këtë rast studimet mund të bazohen në një radhë punimesh të detajuara, të cilat janë zhvilluar sidomos në vende të Ballkanit nga gjuhësia, arkeologjia dhe historia - por që janë të shpërndara në qindra revista, monografi dhe vëllime konferencash të rralla, të publikuara në shumë gjuhë.

Sipas mendimit tim një sfidë kryesore për një ballkanologji me orientim historik paraqet pikërisht kjo, që kjo evidencë të bashkohet me teori përkatëse.

Këtë mund ta realizojnë studiues të formuar për këtë qëllim: pikërisht në një kohë, ku kompetencat përkatëse filologjike reduktohen, është detyrë strategjike të formojnë një grup të vogël studiuesish, dhe këtu akademitë duhet të marrin një rol udhëheqës.

Realitetin historik të Ballkanit të thurur me Evropën dhe hapësirën mesdhetare e paraqita më herët - ajo duhet të përfshihet, dhe me këtë sfidë shkencore dhe kulturore duhet të matet ballkanologjia pordhe ballkanologët.

Por edhe sepse ajo është kaq e shumanshme, komplekse dhe e mundimshme, i lejohet ballkanologjisë t'i kërkojë vetes të jetë një disiplinë e vërtetë evropiane.

Ajo qëndron për rrethanat evropiane për atë paradigmatisht, se nuk përjashtojnë njëri-tjetrin individualitete gjuhësore-kulturore të kombeve moderne—dhe faza të hershme të identifikimeve përkatëse - si dhe përfshirje të mbirënditura (???)

Në këtë kontekst ballkanologjia e historisë evropiane ka për të thënë më shumë nga ç'e ka bërë deri tash, e koncentruar në studime detajesh - por për këtë nevojitet drejtim, një dorë drejtuese.

Kjo mund dhe duhet të jetë detyra e një akademie.